



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr.85 , datë 27.07.2020

“PËR

TRAJTIMIN ME SUBVENCIONIN E QIRASË TË DISA FAMILJEVE NË NEVOJË QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, vendimit nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit”, vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të këshillit të ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, vendimit nr. 10, datë 05.02.2020, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit “Subvencioni i qirasë”, vendimit nr. 11, datë 05.02.2020, të Këshillit Bashkiak “Për ngritjen e komisionit të strehimit”, vendimit nr. 68, datë 12.06.2020 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë për tre zona të qytetit të Tiranës për familjet që nuk mund të përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë”, si dhe bazuar në vendimin e marrë nga Komisioni i Strehimit, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të miratojë trajtimin me subvencionin e qirasë për individët/ familjet, sipas listës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për individët/familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë për një periudhë 1 (një vjeçare), nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga pika “1”, në shumën prej **654897 (gjashtë qind e pesëdhjetë e katërmijë e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë** në muaj, do të përballohen nga fondi i përcaktuar nga zëri i bonusit të strehimit të buxhetit të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R I

TONI GOGU